



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 43 Prot

Tiranë, më 01.06. 2012

VENDIM Nr. 8 dt. 31.05.2012

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, ndryshuar me ligjin nr. 9882, dt 28.02.2008, "Për Trashëgiminë Kulturore", Këshilli Kombëtar i Restaurimeve në mbledhjen e datës 31.05.2012, pasi shqyrtoi projektet e diskutuara në Institutin e Monumenteve të Kulturës, sipas pikave të rendit të ditës:

VENDOSI

Lidhur me diskutimin e projekteve për fondin e zhvillimit të rajonit:

1. **Miratohet:** Projekt i restaurimit të këmbanares së Shën Nikollës, Voskopojë.
2. **Miratohet:** Fondi për konsolidim dhe restaurim i parashikuar në projektin e krijimit dhe rjetëzimit të zonës arkeologjike, Cakran.
3. **Miratohet:** Projekt restaurimi të banesës së Hasan Tasinit Ninat, Sarandë.
4. **Miratohet:** Projekt mirëmbajtje të kishës së Shën Mërisë, Zvërnec. (Të bëhet zëvendësimi i kollonave të dëmtuara prej guri me kollona guri, kollonat e vjetra të vendosen në hajat për ekspozim).
5. **Miratohet:** Projekt restaurimi i kishës së Shën Spiridhonit, Vuno.
6. **Miratohet:** Projekt restaurimi i kishës së Shën Kollit, Krujtje e Sipërme, Lushnje.
7. **Miratohet:** Projekt restaurimi i kishës së shën Todrit, Kadipashaj, Lushnje.
8. **Miratohet:** Projekt restaurimi i kishës së shën Mari, Spile, Tranoshisht, Gjirokastrë.
9. **Miratohet:** Projekti i ndërhyrjeve rest. në manastirin e 40 shenjtoreve, Sarandë.
10. **Miratohet:** Projekt restaurimi ura e Brarit.
11. **Miratohet:** Projekt restaurimi kalaja e Tepelenës. (Gjatë procesit të shqepjes së murit të bëhet dokumentimi i gurëve që do të hiqen dhe të rivendosen ato në të njëjtat pozicione).
12. **Miratohet:** Projekt restaurimi kisha e shën Kollit, Saraqinishte, Gjirokastrë.
 - Ngarkohet sekretaria teknike, për njoftimin e këtij vendimi.
 - Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
 - Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
ALDO BUMÇI

SEKRETAR I KKR
AKADEMIK. APOLLON BAÇE